



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



E K S T R A K T I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 15.03.2022,
duke filluar në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Fehmi Kupina, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Arbnora Berisha, Mirsad Vitia, Gëzim Sveçla, Milazim Vitija, Jeta Rafuna, Donjeta Dragusha, Leutrim Retkoceri, Shegë Beqiri dhe Bahri Gashi.

Mungoi: Nora Kelmendi

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Doruntinë Maloku, drejtoreshë e Drejtorisë së Pronës, Arbër Sadiki, drejtor i Drejtorisë së Urbanizmit, Mimoza Sylejmani, drejtoreshë e Drejtorisë e Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, Fatos Dibra, përfaqësues nga Zyra ligjore, Fatmir Bilalli përfaqësues nga Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Fehmi Kupina, kryesues.**

Kryesuesi e hodhi në votim rendin e ditës.

R E N D D I T E:

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetit për Politikë e Financa;
2. Propozimvendimi për miratimin paraprak të listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës, që planifikohen për dhënie në shfrytëzim në vitin 2022;
3. Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për lagjen "Kalabria", nr.01-350/05 -245432 / 21, i dt.12.11.2021;
4. Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për miratimin e ndryshimit dhe plotësimit të pjesërishtëm të bllokut urban "D3" në kuadër të Planit rregullues "Arbëria3", i miratuar me Vendimin për plotësimin dhe ndryshimin, 01.nr.35-94056 dt.04.05.2015;
5. Propozimvendimi për caktimin e lokacionit të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për strehimin e kafshëve;

Faqe 1 nga 1

6. Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale të Komunës së Prishtinës;
7. Propozimvendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKS);
8. Informatë për punën e Drejtorisë së Inspeksionit ;
9. Informatë për gjendjen me pandeminë COVID-19, në Komunën e Prishtinës;
10. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ky rend dite.

Doruntinë Maloku propozoi me e bërë plotësim ndryshim të listës së veçantë për shkak të kërkesave emergjente që i kanë marrë prej Policisë së Kosovës dhe tjetra prej Ministrisë së Kulturës dhe Sportit, kështu që duhet me i shtuar edhe dy parcela në listën e pronës për shfrytëzimin andaj a duhet tani me bërë këtë procedurë apo kur të vijmë në pikën e rendit të ditës për listën.

Fatos Dibra dha sqarime.

Jeta Rafuna- Hasani propozoi që të hynë si pikë e rendit të ditës për seancë "Formimi i komiteteve tjera të Kuvendit Komunal".

Gëzim Sveçla tha se në mbledhjen e kaluar të KPF -së, kemi pasur një propozim na është thënë se KPF-ja nuk vendos pika të reja por jep si rekomandime.

Fatos Dibra tha se rendin e ditës e cakton Kryetari me kryesuesin e Kuvendi, KPF nuk shtinë pika të rendit të ditës mundet me votuar vetëm rekomandime.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetet për Politikë dhe Financa;

Gëzim Sveçla tha se në mbledhjen e kaluar kam kërkuar që me qenë të furnizuar me material në mbledhje të KPF-së, jemi dakorduar që po, kryesues nuk e ke kryer obligimin.

Bahri Gashi tha se sa i përket materialeve sa na kanë ardhur në email shumë pak, sot po na vinë vendime tepër vonë.

Gëzim Sveçla tha sot na ka ardhur një pikë për gjendjen në shëndetësi, ku Ligji për Veqeverisje lokale shumë qartë e thotë 7 ditë pune para seancës mi pasur materialet.

Kryesuesi tha se herrave tjera keni me marrë materialin me kohë.

Kryesuesi konstatoi se u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së parë të Komitetet për Polikë e Financa

Pika e dytë

Propozimvendimi për miratimin paraprak të listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës, që planifikohen për dhënien në shfrytëzim në vitin 2022

Doruntinë Maloku dha sqarime se në bazë të Ligjit për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të pronës së Komunës e kemi bërë propozimin për miratimin e paraparë të kësaj listë në Kuvend ku ligji kërkon deri me 31 dhjetor të miratohet kjo listë.

Po ashtu të publikohet lista e përgjithshme në faqen zyrtare mirëpo për shkak të një shkrese që na ka ardhur nga MPL -ja kanë kërkuar të zgjatet afati deri me 31 maj të publikimit të këtyre listave.

Ne më 24 shkurtë e kemi bërë publikimin e listës së përgjithshme të pronave komunale në faqen zyrtare të Komunës së Prishtinës dhe si rrjedhojë e kësaj e kemi sjell në Kuvend Komunal për miratimin paraprak të listës së veçantë që duhet të bëhet në Kuvend.

Unë kam sjell që të shtohen në listë edhe 4 parcela që janë për dy çështje e para është për Sallën e Baletit dhe Operesë ku pas diskutimeve është vendosur të ndërtohet mbrapa Pallatit të Rinisë dhe çështja e dyta është çështja e Stacionit Veri të Policisë së Kosovës për ndërtimin e objektit policor që është vendosur që të jetë objekti në Dragodan në afërsi të KFOR-it dhe policisë ju ka përshtatur si lokacion, në fund të listës janë këto parcelat që do të shtohen në listë.

Gëzim Sveçla tha se vendimi që na është dorëzuar do të na paraqitet në Kuvend për tu votuar, në vendim te pika e dytë thotë sipas pikës së I të këtij vendimi lista për secilën pronë përmban: arsyetimin e interesit publik dhe zhvillimit ekonomik të Komunës, të dhënat kadastrale, qëllimin e dhënies në shfrytëzim, destinimin, datën e publikimit të njoftimit, si dhe periudhën kohore për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, ne për këto prona nuk kemi këto të dhëna , na është sjell vetëm lista të cilën kemi më votuar.

Doruntinë Maloku dhe sqarime.

Gëzim Sveçla tha se kjo ka me u kthyer nga MAPL -ja, dhe ka me u refuzuar siç e kemi rastin më Komunën e Obiliqit.

Doruntinë Maloku sqaroi se në faqen zyrtare te Komunës së Pejës mundeni me pa listën që është identike me këtë që është miratuar në Kuvendin Komunal dhe MAPL-ja e ka kthyer ligjshmërinë.

Gëzim Sveçla tha se ligji e parasheh edhe dhënien e arsyeshmërisë.

Fatos Dibra dha sqarime se në ligj shkruan lista e pronave të paluajtshme për dhënien në shfrytëzim duhet të përmbajë këto të dhëna, të dhënat kadastrale të pronës, qëllimin, destinimin dhe datën e publikimit.

Gëzim Sveçla tha se cili ligj është dhe ligji a nuk e parasheh arsyeshmërinë.

Fatos Dibra tha se ligji për dhënien në shfrytëzim të pronës komunale dhe këmbimin e pronës, jo ligji nuk e thotë arsyeshmërinë.

Gëzim Sveçla pyeti a mundet Kryetari me bërë negociata.

Fatos Dibra dha sqarime se edhe me negociata Kryetari nuk ka të drejt me dhënë prona në shfrytëzim direkt, Kryetari ka të drejt me negociuar, me paraqit ofertën në Kuvend Komunal dhe me dhënë propozim që po ja jep këtë në shfrytëzim.

Doruntinë Maloku tha se kjo listë kryesisht është për zonën ekonomike dhe ne i kemi vendosur në listë për me i pa që nëse eventualisht kemi kërkesë prej investitorëve që ne me i parë që mos me na pamundësuar që mos me qenë në listë.

Bahri Gashi tha se në emër të transparencës me shkel ligjin nuk ka kuptim na po dëshirojmë me bërë transparencë e këtu po e shkelim ligjin, është mirë me plotësuar se janë të dhënat e pa definuara, sa i përket Teatrit të Operës dhe Baletit po më intereson ku mbrapa "Pallatit të Rinisë", për Stacionin e Policisë jemi për me ju siguruar prona.

Doruntinë Maloku dha sqarime.

Jeta Rafuna - Hasani tha se e përgëzoj drejtoreshën për këtë listë që e ka përpiluar dhe e ka publikuar në web-faqe fatmirësisht tani për vitin 2022 kemi njohuri se cilat prona do të jepen dhe ku e kanë destinimin e tyre. Po ashtu tha se çdo gjë është sipas ligjit.

Fatos Dibra dha sqarime, se lista i përmban të dhënat përveç qëllimi, arsyeshmëria jepen në momentin kur vjen në Kuvend Komunal për votim dhënien e pronës në shfrytëzim.

Arbër Sadiki tha se është krijuar një lajthitje për shkak së të propozimi për Teatrin e Operës dhe Baletit, e dimë për çka e vendosim për ndryshe asnjë parcelë se dimë për çka kanë mu shfrytëzuar.

Gëzim Sveçla tha se nëse është siç po e cek zyrtari i Zyrës ligjore, atëherë në vendim që ka mu votuar në Asamble në pikën II më e rregulluar arsyetimin e interesit publik dhe zhvillimit ekonomik të Komunës.

Fatos Dibra dha sqarime.

Gëzim Sveçla tha se nuk jemi mos me kaluar kjo listë por jemi me kaluar në mënyrë të rregullt siç e parasheh ligji, po ashtu pyeti të pika 6 dhe 7 a kemi groposje a çka është.

Doruntinë Maloku dhe sqarime për pyetjen.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për miratimin paraprak të listës së veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës, që planifikohen për dhënien në shfrytëzim në vitin 2022 dhe dërgohen në Kuvend për miratim.

Pika e tretë dhe e katërt

Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për miratimin e Planit rregullues të hollësishtëm për lagjen "Kalabria", nr. 01-350/05 -245432/21, i dt.12.11.2021.

Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për miratimin e ndryshimit dhe plotësimit të pjesërishëm të bllokut urban "D3" në kuadër të Planit rregullues "Arbëria3", i miratuar me Vendimin për plotësimin dhe ndryshimin, 01.nr.35-94056 dt.04.05.2015.

Mimoza Sylejmani dha sqarime duke cekur se në mbledhjen e fundit të seancës të qeverisjes së kaluar na ka ardhur Kalabria me votuar si plan rregullues, atë ditë ka ardhur një propozim nga një asamblistë që ka kërkuar nga 1.8 në 2.4 me u bërë koeficienti dhe u bë diskutim.

Unë e kam lëshuar mbledhjen për shkak se nuk mundet propozimet aty për aty pa pjesë grafike pa u ditë ku është përcaktuar lokacioni për shkollë, çerdhe për shumë probleme tjera.

Sa i përket Arbërisë ka ardhur i cili ka qenë pa procedura nuk ka ardhur nga Drejtoria e Planifikimit, nuk ka kaluar nga Zyra ligjore ka ardhur kinse me notë verbale të Ambasadës Amerikane për me votua.

Kjo nuk ka pasur as diskutim publikë, atë ditë kur është votuar është potencuar se pjesën grafike do ta sjellin d.m.th. është votuar si me kusht që pjesa grafike do të vjen dhe Ministria e Planifikimit e ka kthyer të jashtë ligjshme dhe e ka shpjeguar shumë mirë dhe të detajuar se si është shkel ligji edhe pse Komuna në atë kohë pas 15 ditëve e ka publikuar në faqen zyrtare.

Arbër Sadiki tha se të gjitha i sqaroi Mimoza, Ministria e Planifikimit i ka thënë të gjitha këto efekte shkurt por shumë saktë komplet këto efekte që i ka.

Gëzim Sveçla tha se kisha kërkuar si është në opinion prej Zyrës ligjore të Komunës për këtë rast cili plan i hollësishëm zhvillimor është në fuqi sot, a ka hyrë ky plan për shkak se drejtoresha e ceku që ligjshmëria faktikisht nuk është ligjshme por opinion i MAPL -së ka ardhur pas afatit, sa është ky afat, a është plani i cili është votuar në muajin nëntor a është sot në fuqi në Kalabri.

Fatos Dibra dha sqarime.

Gëzim Sveçla d.m.th lagjja Kalabria sot e ka në fuqi planin e hollësishëm të votuar në muajin nëntor, pa marr parasysh vërejtjet si është miratuar dhe Ministria ka reaguar vonë dhe ai plan është në fuqi. A ka pasur në praktika më të hershme që ka dërguar MAPL-ja për plane të tjera të lagjeve të tjera me të cilat nuk është marrë hiq Kuvendi Komunal i Prishtinës dhe po dua me ditë konkretisht cila është kërkesa e drejtorive a është me votuar.

Fatos Dibra tha se sa i përket kësaj pike edhe në të kaluarën po janë kthyer nga Ministria me sa kam informatën nga Drejtoria e Planifikimit i ka të dhënat ma mirë dhe Zyra e Kuvendi ka edhe plane rregulluese në të kaluarën që janë kthyer por nuk e di a brenda afatit apo jashtë afatit por janë kthye nga Ministria si të jashtë ligjshme.

Arbër Sadiki tha se një pikë është ligjshmëria, pika tjetër është po flas prej këndit profesional, nuk ka kurrfarë kuptimi në vitin që ne po merremi me PZH dhe Hartën zonale mu marrë me plane rregullative sepse ideja është në momentin që aprovohen Planet Zhvillimore Komunale të reja dhe Hartat zonale gjithë planet rregullative deri tani mu shfuqizuar.

Unë po them individualisht edhe mos ta ketë kthyer Ministria e Planifikimit, plani rregullativë në Prishtinë nuk duhet më u bërë deri sa të bëhen PZH dhe Harta zonale.

Jeta Rafuna Hasani pyeti kur planifikohet me u kryer PZH dhe Harta zonale.

Gëzim Sveçla tha se unë mendoj në këtë rast nuk ka politikë, ne duhet me gjetur zgjidhje më të mirë të mundshme pa e dëmtuar qytetin, por pikë së pari ti mbrojmë interesat e banorëve të lagjes, duhet me bërë një revidim të planit e jo me anuluar krejt.

Mimoza Sylejmani tha se inkorporohen në Hartë zonale.

Bahri Gashi tha se jam mos me e anuluar këtë plan, jam për me përmirësuar me punuar me bërë gjithçka që me plotësuar këtë plan nga personat kompetentë.

Leutrim Retkoceri tha se lidhur me pikën në fjalë na sqaroi drejtoresha, është fjala për një hartë e cila nëse e kanë banorët në dorë koeficientet janë të ndryshëm dhe gjithë grupet kanë votuar nëse ju barazohet koeficienti qytetarëve 2.4 të gjithë ky ka qenë qëllimi.

Ideja ka qenë si e tillë dhe problemi është nëse i marrim qytetarët në takim më tërësi, nëse e marrim pjesën ku është rritur koeficienti ata nuk dëshirojnë me u anuluar ky plan nëse i marrim ata që e kanë koeficientin P+2 çka thonë ata si ka vet askush këtu është problemi që nuk ka ardhur me procedura qysh është dashur dhe ka ardhur në emër të kolektorit.

Po ashtu tha se të gjithë në atë kohë kemi menduar me barazuar këtë koeficient e mos me ja lënë një rrugë koeficientin me ndërtuar 2.2, tjetri 2.4 e tjetri 3 pse kështu se kush ka qenë i fort ja ka ngrit vetes koeficientin.

Sa i përket propozimit a jeni për me ndërruar këtë formë të ndërtimit në Prishtinë si ka shkuar që 20 vite, unë jam për me ndërruar dhe me i dhënë mbështetje politike. Duhet me ju dhënë mbështetje këtyre njerëzve, nëse Kryetari ka premtuar për 6 muaj vjen e rregullon ne duhet me kërkuar me ardhur sa më shpejt ai plan dhe me votuar dhe me qenë plan i ligjshëm që kurë nisin ata me ndërtuar lagjen më ditë çka po ndërtojnë e mos me ndodhë si Mati I e shumë lagje tjera në Prishtinë.

Këtu po flitet se është anulim i planit procedura e kërkon të tillë është mirë me sqaruar nëse Ministria ka thënë vendimi të shkohet me procedim e këtë procedim Ministria nuk mundet me marrë për neve por na e marrim atëherë është anulim i këtij plani, vjen Plani i ri dhe implementohet është si i tillë dhe për të mirë të tyre është nëse ajo lagje ka mu planifikuar dhe mu bërë siç duhet.

Mimoza Sylejmani tha se unë e kam sjell se Ministria me thotë mua dhe e ka cek pikë për pikë shumë mirë pse nuk duhet të bëhet ky plan rregullues, unë qëndroj prapa vendimit të Ministrit.

Arbër Sadiki tha se për mua është me rëndësi që thotë Ministria kjo pika e fundit të Kalabria ku thotë e inkurajojmë Komunën e Prishtinës që sa më parë të mbyll procesin e hartimit të Hartës Zonale dhe PZH në mënyrë që kërkohet e tilla të adresoj në këto dokumente siç e parasheh ligji.

Bahri Gashi tha se nuk pajtohem që të anulohet ky vendim.

Gëzim Sveçla tha se është një vendim i Kuvendit Komunal të Prishtinës që është votuar kemi ardhur në një shkallë tjetër që është një vendim i MAPL-së, i cili është dorëzuar pas kohës që është i paraparë me ligj që i bie se është i jashtëligjshëm në një farë mënyre në bazë të këtij vendimi të jashtë ligjshëm kemi më votuar me anuluar një vendim të ligjshëm se i ka marrë votat në Kuvend që nuk ka qenë profesional dhe është krejt çështje tjetër, ne unanimisht kemi me deklaruar se jemi kundër këtij vendimi.

Milazim Vitija tha se është e vërtetë që ne e kemi votuar këtë plan urbanistikë me arsyetime të ndryshme që ka pasur atëherë, koeficienti mu rritë për të gjithë së ka qenë kërkesë e banorëve tani i kemi këto procedurat e Ministrisë përkatëse dhe kemi ardhur në këtë situatë që është e vërtetë që ne patëm kërkuar që asnjë plan urbanistik mos me ardhur pa Hartë zonale.

Po ashtu e kam një pyetje sa merr kohë me u bërë Harta zonale, PZH a mundet deri 6 muaj e me ju bërë zgjidhje këtyre banorëve.

Arbër Sadiki dhe sqarime.

Kryesuesi tha së e qesim në Kuvend e aty vendosni a e votoni a jo e këtu mundemi vetëm me debatuar.

Gëzim Sveçla pyeti a është i njëjti vendim edhe për pjesën e Arbërisë.

Fatos Dibra dha sqarime.

Leutrim Retkoceri tha se si pika unë kisha thënë se duhet mu nda mos me qenë e njëjta me rastin e Arbërisë, mos me qenë as si votim as të njëjtën datë, sepse mendoj pa marrë parasysh se qysh kanë me ardhur kanë me dalluar për shkak të situatës.

Unë nuk jam me përkrah një plan pse ambasada po ta sjell e me lënë Kalabrinë këndeje, që si plan me u nda se nuk është rasti urgjentë si në Kalabri le të shtyhet ta trajtojmë Kalabrinë me prioritet e ti japim hapësirë që të punohet në Kalabri e mandej të rregullohet se ajo pjesa të ambasada është e vogël.

Fatos Dibra tha se një këshillë ligjore po e jap së arsyetimi për anulim për dy planet është se janë kthyer nga Ministria se janë të jashtë ligjshme dhe po anulohen për shkak të ligjshmërisë së vendimit dhe mendoj nuk është mirë Kuvendi me punuar me dy standarde.

Gëzim Sveçla tha se është pikërisht kjo që po e thotë zyrtari i Zyrës ligjore d.m.th. tani kemi të bëjmë me ambasadën dhe po e lëmë të mirën e qytetit për shkak se po intervenon ambasada dhe nuk po e anulojmë këtë vendim ky është parim i dyfishtë ose të dyjat ose hiq.

Arbër Sadiki tha se si plane dallojnë shumë njëra me tjetrën për këtë edhe arsyetimet e Ministrisë janë bukur të ndryshme se si i arsyeton si të para si të e dyta.

Kryesuesi konstatoi se u miratuan Propozimvendimet për anulimin e Vendimit për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për lagjen "Kalabria",nr.01-350/05-245432/21,i dt.12.11.2021 dhe Propozimvendimi për anulimin e Vendimit për miratimin e ndryshimit dhe plotësimit të pjesërishëm të bllokut urban "D3" në kuadër të Planit rregullues "Arbëria 3", i miratuar me Vendimin për plotësimin dhe ndryshimin, 01.nr.35-94056 dt.04.05.2015 dhe dërgohen në Kuvend për miratim.

Pika e pestë

Propozimvendimi për caktimin e lokacionit të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për strehimin e kafshëve

Milazim Vitija tha se kjo strehimore ka më qenë në Slivovë ma lartë se liqeni i Badovcit dhe në atë pjesë se di me çfarë arsye ndërtohet atje në atë anë nga Lipjani është ndërtuar një kopshte i qenve në anën tjetër kopshti i arinjve tash edhe një strehimore e qenve nuk e di a nuk kanë pasur vend ku me i vendosur a pse janë drejtuar kopshti i arinjve, kopshti i qenve dhe strehimorja e kafshëve komplet ato ujëra me u derdhur në Badovc të uji i pijes.

Unë nëse nuk ka sqarime të duhura nuk e votoj këtë se duhet me ditë ku po ndërtojmë dhe çka po bëjmë ka pjesë të tjera edhe më lartë që nuk e pengojnë as nuk vijnë ujërat në liqe.

Leutrim Retkoceri tha se pajtohem me z. Vitija se e ka një afërsi me Badovcin, drejtori ose drejtoresha cili e ka marr mbi sipër duhet mi dhënë këto a mundet ky ndërtim edhe a i plotëson kushtet, me marrë leje ambientale prej Ministrisë.

Problemi i qenve endacak është problem permanent në Prishtinë është mirë me i dhënë zgjidhje duke e ruajtur ujin dhe ambientin se e kemi obligim.

Bahri Gashi u interesua për strategjinë për problemin e qenve endacak që është premtuar nga Kryetari që kjo strategji të sillet në Kuvend.

Kryesuesi tha se nuk është kompetencë e imja me fol për strategjinë e qenve endacak kompetencë është e nënkryetarit që ka thënë do ta kemi një takim për këtë.

Në Kuvend duhet dikush me arsyetua atë lokacion ku është planifikuar ndërtimi dhe e jona është a e votojmë a jo.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për caktimin e lokacionit të pronës së paluajtshme të Komunës së Prishtinës për strehimin e kafshëve dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale të Komunës së Prishtinës

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për caktimin e anëtarëve në komisionet e aksionarëve të ndërmarrjeve publike lokale të Komunës së Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB)

Lidhur me këtë pikë informoi **Fatmir Bilalli**, i cili tha se neni 3 është themelimi i KKSB, që do të thotë çdo komunë obligohet të formoj ndërsa neni 4 është përbërja e KKSB, ku shumica e emrave që i keni në listë na ka ardhur në bazë të pozicioneve të cilat i kanë anëtarët ku është Kryetari Komunës, komandantët të stacioneve të Policisë, këshilla lokale të sigurisë publike etj. Po ashtu ceku se kanë pasur disa OJQ që i kanë dërguar emrat e përfaqësuesve ku ndërkohë një OJQ ka kërkuar që të ndërrohet një përfaqësues Serbeze Sylejmani e të zëvendësohet me Skender Perteshi.

Gëzim Sveçla pyeti se a ka pasur intervista për këta kandidat.

Fatmir Bilalli tha se nuk ka pasur intervista, ne vetëm ju kemi dërguar emaile si bashkësive fetare, OJQ-ëe e ata i kanë propozuar vetë.

Jeta Rafuna Hasani pyeti a janë përfshirë këta përfaqësues të gjitha lagjeve.

Fatmir Bilalli tha se nuk janë përfaqësues të lagjeve, dhe përbërja e këtij komiteti është përcaktuar sipas neni 4 të udhëzimit administrativ, ku cek se kush mundet të jetë anëtarë.

Bahri Gashi pyeti se, këshillat e rijnë që formohen a plotësohen në këtë listë dhe a lejohet këtu vëzhgues, a mundemi ne me qenë vëzhgues, unë jam i interesuar me qenë vëzhgues.

Fatmir Bilalli tha se një lagje mundet me formuar këshillin dhe prapë vjen emri i tyre e propozohet. Sa i përket vëzhgimit po mundet, zakonisht si vëzhgues i kemi OSBE, KFOR-in, mjetet e informimit, por mundeni edhe ju me ardhur.

Milazim Vitija sugjeroi që në të ardhmen me pasur përfaqësues edhe nga Mareci , Slivova se nuk e kanë përfaqësuesin e vet për siguri në bashkësi se është një hapësirë e madhe dhe duhet ta ketë.

Fatmir Bilalli dha sqarime.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tetë

Informatë për punën e Drejtorisë së Inspeksionit

Kryesuesi konstatoi se u miratua Informatë për punën e Drejtorisë së Inspeksionit dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.

Pika e nëntë

Informatë për gjendjen me pandeminë COVID-19 në Komunën e Prishtinës

Kryesuesi tha se lidhur me këtë pikë na ka ardhur një informatë me vonesë nga drejtori.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Informata për gjendjen me pandeminë COVID-19 në Komunën e Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për diskutim.

Të ndryshme

Kryesuesi informoi se Asociacioni i Komunave të Kosovës e kanë një takim me 5 prill dhe i kanë kërkuar pesë emra mi dërguar, a vendosemi këtu e dakordohemi e nuk e dergojmë në Kuvend.

Z. Sveçla ka thënë se VV-së i takojnë dy përfaqësues ndërsa grupet tjera e kanë kundërshtuar.

Gëzim Sveçla tha se ne nuk mundemi të dakordohemi, pasi që ne jemi një grup me 17 asamblistë e nuk është njëjtë si një grup që i ka 3 apo më pak asamblistë dhe me dërguar nga një përfaqësues.

Jeta Rafuna Hasani tha se qëndroj prapa asaj që e kamë thënë në takimin me SHGP-së, jam për marrëveshje që pesë partive me ju takuar dhe me dërguar nga një përfaqësues e nëse nuk dakordohemi e dërgojmë në Kuvend.

Faqe 9 nga 11

Gëzim Sveçla tha se ku është logjika pesë partive me ju taku nga një përfaqësues në ftesë shkruan shumë mirë përfaqësimi është sipas përfaqësimit të tyre në Kuvend.

Leutrim Retkoceri tha se është mirë parimi gjithëpërfshirës ose e dërgojmë në Kuvend.

Gëzim Sveçla tha se në seancën e fundit nënkryetari ka premtuar se kemi me diskutuar si pikë të veçantë për "Prishtina Parking", a është punuar diçka në këtë drejtim se në rendin e ditës nuk e kemi këtë pikë.

Kryesuesi u përgjigj që jo.

Leutrim Retkoceri tha se edhe mua po më intereson lidhur me këtë pikë nëse ka me qenë mundësia me diskutuar për këtë çështje se janë qytetarët në hall me këtë punë, se premtimet kanë qenë me ftuar kryeshefin e ndërmarrjes me marrë pjesë në takim dhe ka me qenë një pikë e rendit të ditës për rregullore.

Po ashtu tha se janë dy rregullore që ka mos përputhje edhe problemi është në opinion publik flitet se Kuvendi Komunal po i bënë këto rregullore dhe po i gjobit qytetarët nëse nuk është bërë asgjë atëherë të shohim a është mundësia me diskutuar për këtë çështje.

Jeta Rafuna Hasani tha se si informatë kryetari e ka themeluar një komision për plotësim ndryshimin e rregullores "Prishtina Parking", dhe besoj në të ardhmen ju informojnë.

Gëzim Sveçla propozoi si rekomadim të jetë si pikë e veçantë "Diskutimi i gjendjes në Ndërmarrjen Prishtina Parking".

Bahri Gashi tha se rregullorja duhet me u rregulluar edhe të çmimet, për hapësirat për invalid etj.

Milazim Vitija tha se është një kërkesë prej qytetarëve për drejtorin e Drejtorisë së Kadastrit që çdo pronë që e trashëgojnë apo jua fal dikush e paguajnë transaksionin shumë, prandaj kërkojë ose të hynë në rend dite ose të e dërgojmë si rekomandim që kjo çështje të rregullohet ose të ulen për 50% ose të largohet krejt se kjo është arsyeja që qytetarët e Prishtinës nuk po i bartin mbi vete pronat.

Kryesuesi dha sqarime lidhur me këtë çështje dhe u deklarua se është për me larguar këtë pagesë.

Fatos Dibra dha sqarime lidhur me këtë çështje.

Bahri Gashi ju drejtua kryesuesit që ti fton drejtorët që të jenë në takim e të raportojnë për çështjet që ju takojnë po ashtu dhe pikën pyetje dhe përgjigje në Kuvend me vendos në fillim të seancës kështu që në fillim na përgjigjen drejtorët për pyetjet e parashtruara.

Kryesuesi tha se çdo herë i fton të gjithë drejtorët që të jenë në takim .

Donjeta Dragusha tha se në KPF, nuk kemi pyetje e përgjigje.

Kryesuesi tha për seancë të Kuvendit po kërkon po ashtu edhe Jeta për formimin e komiteteve tjera .

Leutrim Retkoceri tha se a i koordinojmë, a na duhet ma shumë kohë me ditë cilat komitete po i formojmë.

Jeta Rafuna Hasani dhe sqarime.

Mirsad Vitia propozoi që mbledhja e KPF-së, të mbahet një javë para seancës së Kuvendit që propozimet që vijnë këtu me pas kohë GP, me u takuar dhe me i shqyrtuar pikat e rendit të ditës që kanë me ardhur në Kuvend.

Kryesuesi e hodhi në votimin propozimin e Jetës si rekomandim "Formimi i Komiteteve tjera funksionale në Kuvend".

Kryesuesi konstatoi se unanimisht u votua propozimi i znj. Rafuna.

Po ashtu e hodhi në votimin propozimin e Gëzimit si rekomandim "Informatë mbi gjendjen e Prishtina Parkingut".

Kryesuesi konstatoi se unanimisht u votua propozimi i z. Sveçla.

Leutrim Retkoceri tha se nuk është mirë si parim me qenë pika e ndryshme pyetje e përgjigje në fillim të seancës se përmbajtja është më e rëndësishme se forma po ashtu është diçka me rëndësi se kjo puna me fol tri here nuk është në pyetje me ja ndalë dikush fjalën, me qenë pak ma ekspeditivë në kohë që me mundur me i dhëne mundësi të gjithëve me fol por kur flasim më qenë ma të shkurtë me një qëllim.

Kryesuesi tha se nëse lëshohemi në përmbajtje shumë shpejt kemi me kryer takimin për ndryshe nëse lëshohemi në formë do të zgjasin shumë takimet.

Mbledhja përfundoi në orën 12 :30.

**Procesmbajtësja
Shyhrete Islami**

**Kryesuesi i Komitetit
Fehmi Kupina**



Faqe 1 nga 1